



Titulli i projektit

Krijimi i Zyrës së Arkivave dhe Bazës së të dhënave për bashkinë Mat dhe Klos

Tipi i projektit

Shërbimet Publike

Vendndodhja e projektit

Bashkia Mat dhe Klos,

Buxheti i paravlerësuar

4,000,000 lekë

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve


Në situatën e re të dalë nga shkrija dhe bashkimi i njësive të qeverisjes lokale në njësi më të mëdha, ofrimi i shërbimeve publike efektive pritet të jetë një prej rrjedhojave bazë të synuara. Ruajtja e stadi të arritur në shërbimet aktuale dhe përmirësimi i mëtejshëm, janë tendenca që duhet të ecin paralelisht. Pavarësisht mënyrës së ofrimit të shërbimeve publike, informacioni mbështetës (regjistra populsie, asete, tatimpagues, biznese, etj.) duhet të jetë i integruar. Kjo nënkupton integrimin e arkivave fizike në njësitë e reja që do të krijohen dhe krijimin e bazave të të dhënave të integruara fizike dhe elektronike për të dy njësitë bashkiake Mat dhe Klos. Gjithashtu, kjo nënkupton edhe instalimin e një sistemi informacioni të brëndshëm, të përdorur për mirëmbajtjen dhe aksesin në këto të dhëna nga njësitë e shërbimeve.

Qëllimi/et specifik të projektit

Krijimi i bazave të të dhënave të integruara, fizike dhe elektronike, për njësitë e bashkive Klos dhe Mat.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

- Krijimi i bazës së të dhënave fizike dhe elektronike për njësitë bashkiake Mat dhe Klos (zyrat e arkivave qendrore dhe lokale, sistemi i klasifikimit dhe formati letër, elektronik dhe fotografik, dosjet dhe raftet, ndriçimi dhe ruajtja e regjistrave, manuali i aksesit dhe transferimeve të të dhënave);
- Konceptimi i arkitekturës dhe skemës së përdorimit të të dhënave nga njësitë e shërbimeve (serverat qendrore, serverat lokalë, koha e migrimit të të dhënave dhe formati);
- Zgjedhja e software dhe e licensave për përdorimin e të dhënave nga njësitë e shërbimeve (open source apo sistem i thjeshtë i bazës së të dhënave Access, apo My SQL);
- Trainimi i personelit dhe krijimi i manualeve për përdorimin e të dhënave (nga një kurs trainimi për njësitë e shkrija dhe një manual i përbashkët trainimi).



Aktivitetet e projektit

- Prezantimi i konceptit dhe përfitimet e arkivave të integruara;
- Studimi dhe përzgjedhja e konceptit;
- Tenderimi dhe zgjedhja e kompanisë zbatuese;
- Rinovimi dhe adaptimi i ambienteve, instalimi i pajisjeve kundër zjarrit dhe lagështisë;
- Blerja e pajisjeve: servera dhe licensat e përdorimit, makina fotokopjuese me skanera të integruar, dosje, raftë, pajisje ajrimi për arkivat;
- Instalimi i programit të shfrytëzimit të të dhënave dhe sistemit të përdorimit të brëndshëm;
- Zhvillimi i manualeve të përdorimit;
- Punësimi personeli, trajnimi dhe testimi.

Maturimi i projektit

Nuk ka një studim fillestar. Do të duhet të adaptohen studime paraprake nga njësi të tjera vendore e të kërkohet asistencë nga njësi më të përparura të qeverisjes lokale.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burimet e Financimit:

- Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
- Transferata e Pakushtëzuar
- Donatorët
- Fondi i Mbështetjes së Decentralizimit

Partnerët:

- Bashkia Mat
- Qeveria Qëndrore dhe Këshilli i Qarkut
- AKSH
- Donatorë: UNDP, OSBE, BE

Kostot e projektit

Kosto e Projektit (për bashkitë Mat, Klos dhe të gjitha njësitë që do të shkrimen)

- Prezantimi i konceptit dhe përfitimet e arkivave të integruara,
- Studimi dhe përzgjedhja e konceptit,
- Tenderimi dhe zgjedhja e kompanisë zbatuese 500,000lekë
- Rinovimi dhe adaptimi i ambienteve, pajisje kundër zjarrit dhe lagështisë
- Blerja e pajisjeve: servera dhe licensat e përdorimit, makina fotokopjuese me skanera të integruar, dosje, raftë, pajisje ajrimi për arkivat 3,000,000lekë
- Instalimi i programit të shfrytëzimit të të dhënave dhe sistemit të përdorimit të brëndshëm
- Zhvillimi i Manualeve të përdorimit 500,000lekë
- Punësimi personeli, trajnimi dhe testimi

Të përfshira në zërin e mësipërm

Total: 4,000,000 lekë